PROGRAMI KOMBËTAR I PRAKTIKAVE TË PUNËS, THIRRJA VI

Në zbatim të Vendimit nr. 395, datë 29.04.2015, të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike*", i ndryshuar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall thirrjen e gjashtë të "Programit Kombëtar të Praktikave të Punës".

Informacionin rreth Programit, institucionet pjesëmarrëse, numrin e praktikantëve dhe profilet studimore të kërkuara mund t'i gjeni në linkun: http://praktika.arsimi.gov.al, nga ku mund të kryeni edhe aplikimin online, pasi të klikoni në dritaren "Aplikimi".

Aplikimi është i hapur për të rinjtë, që përmbushin këto kritere:

- ✓ Të jenë **21-26 vjeç**;
- ✓ Të kenë përfunduar **minimalisht** ciklin e parë të studimeve **"Bachelor"**;
- ✓ **Të mos kenë qenë pjesë e** programit gjatë **thirrjeve të mëparshme** .

Të rinjtë e interesuar duhet të aplikojnë vetëm në një institucion të caktuar, në të kundërt aplikimi i tyre nuk do të merret në konsideratë.

Dokumentet që duhet të ngarkojnë aplikantët janë :
a- CV (jetëshkrimin) e aplikantit;
b- Letra e motivimit

Afati për aplikim është nga data 9 Korrik deri më datë 31 Korrik 2021.

Pas mbylljes së aplikimeve, institucionet përkatëse do të lajmërojnë nëpërmjet postës elektronike të përzgjedhurit për të filluar praktikën 3- mujore, në periudhën 16 gusht 2021 - 16 nëntor 2021.

Pjesëmarrësit do të përfshihen në një përvojë pune, në ndërveprim me profesionistët në administratën publike, institucionet e tjera publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe shoqëritë tregtare, me qëllim përfitimin e njohurive praktike, pasurimin e jetëshkrimit të tyre, zgjerimin e rrjetit të kontakteve, aftësimin e mëtejshëm për punën në grup, përshtatshmërinë me ambientin e punës, ndërmarrjen e iniciativave etj..

Të gjithë praktikantët që e përfundojnë praktikën me sukses pajisen me certifikatë lëshuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Deparamenti i Administratës Publike dhe periudha tre - mujore e praktikës njihet si përvojë pune nga Departamenti i Administratës Publike.